



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KUKËS

VENDIM

Nr. 73 Datë 24.12.2021

PER

MIRATIMIN E KALENDARIT TË AKTIVITETEVE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFAT MESËM (PBA) 2023-2025 DHE TË BUXHETIT VJETOR 2023.

Këshilli Bashkiak Kukës, në mbledhjen e tij të datës së mësipërme, pasi shqyrtoi projekt-vendimin e paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, bazuar në ligjin Nr.139/2015 të miratuar me datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 8/2, 9/1/1.1/b, 54, ligjin Nr.44/2015, të miratuar me datë 30.04.2015 “Kodi i Proçedurave Administrative të RSH”, ligjin Nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), ligjin Nr.10 296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar), ligjin Nr.68/2017, të miratuar me datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 33, Ligjin nr.115/2021 datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.8, datë 29.03.2012 “Për proçedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afat-Mesem”, udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.2, datë 06.02.2012 “Për proçedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimin Nr. 7, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2022-2024” Udhëzimin Plotësues Nr.20, datë 09.07.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2022-2024”, Shkresës Nr.18976 prot datë 29.10.2021 “Dërgohet për njoftim transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale, për vitin 2022”,

VENDOSI

1. Të miratojë kalendarin e aktiviteteve të programit buxhetor afatmesëm (PBA 2023-2025) dhe të buxhetit vjetor 2023, bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut.

**KRYETARI I KËSHILLIT
ANILDA BIBA**

